

PRILL 2022

BALLKANI I QËNDRUESHËM

FUQIZIMI

I QËNDRUESHMËRISË SË RINISË NDAJ KRIMIT TË ORGANIZUAR



ANESA AGOVIĆ DHE WALTER KEMP

BALLKANI I QËNDRUESHËM

Ky studim i shkurtër është pjesë e serisë së Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), të titulluar "Ballkani i Qëndrueshëm", ku trajtohen temat me interes të përbashkët për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në Ballkanin Perëndimor, të cilat trajtojnë problematikat që ndërlidhen me krimin e organizuar. Në këtë studim të shkurtër, shqyrtohen faktorët që i bëjnë të rinjtë të cenuar ndaj krimin të organizuar në rajon dhe paraqiten mënyrat se si janë duke punuar OSHC-të me ata në drejtim të fuqizimit të qëndrueshmërisë.

Ky raport është rezultat i Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore të GI-TOC-së dhe i Fondit të Qëndrueshmërisë të GI-TOC-së.

Raporti mbështetet në të dhëna, informacione dhe analiza të mbledhura dhe të dhëna nga faktorët e shoqërisë civile, që ndodhen në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në veçanti, autorët dëshirojnë të falënderojnë Fatjona Mejdinin, Aleksandër Sërbinovskin (Aleksandar Srbinovski), Sasha Gjorgjeviçin (Saša Đorđević) dhe Kristina Amerhauserin (Kristina Amerhauser) për komentet dhe kontributet e tyre. Një falënderim i madh shkon edhe për përfituesit e granteve të "Fondit të Qëndrueshmërisë" të GI-TOC-së për pjesëmarrjen e tyre të sinqertë dhe konstruktive gjatë gjithë këtij procesi.

Ky publikim u mundësua me mbështetjen financiare të Zyrës së Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Lënda e botimit është përgjegjësi vetëm e GI-TOC-së dhe nuk pasqyron patjetër pikëpamjet e qeverisë së Gjermanisë.

© 2022 Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet riprodhimi ose transmetimi i asnjë pjese të këtij publikimi në asnjë formë ose mjet, pa lejen me shkrim të Iniciativës Globale.

Kopertina © Joos Mind/Getty Images; AAM Vilaznia-Taekwondo

Jeni të lutur të dërgoni pyetjet tuaja në adresën:

The Global Initiative Against Transnational Organized Crime

Avenue de France 23

Geneva, CH-1202

Switzerland

www.globalinitiative.net

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME	2
HYRJE: PSE TË PËRQENDROHEMI TE RINIA?	5
RREZIKU DHE CENUESHMËRIA	7
VEPRIMTARITË E OSHC-VE QË MERREN ME ÇËSHTJET E RINISË	15
ZHBLLOKIMI I POTENCIALEVE TË RINISË	24
SHËNIME	25





GI-TOC-ja mbështet organizatat në mbarë Ballkanin Perëndimor që punojnë me të rinjtë dhe i fuqizon ato në përpjekjet e tyre për luftën kundër krimit dhe korrupsionit.

© Klubi "MASA" në Mostar

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME

Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, të rinjtë janë të përfshirë ose shfaqin dobësi ndaj një shumëllojshmërie veprimtarish të krimit të organizuar, duke përfshirë kultivimin dhe trafikimin e drogës, punën e seksit, trafikimin e qenieve njerëzore, zhvatjen dhe vjedhjen e automjeteve ose punën si "ushtarë terreni" për grupet kriminale. Të tjerët vendosin të ikin nga vendi në mënyrë të parregullt, të nisen kontrabandë jashtë shtetit dhe të merren me veprimtari kriminale, sidomos në BE. Çfarë roli luan rinia e Ballkanit Perëndimor në krimin e organizuar? Cilët janë faktorët që e bëjnë atë të cenueshme? Çfarë mund të bëhet për ta larguar rininë nga kurthi i krimit dhe për të parandaluar recidivizmin?

Edhe pse rinia në Ballkanin Perëndimor është e ekspozuar ndaj krimit të organizuar dhe është e përfshirë në të, organizatat e shoqërisë civile (OSHC), që drejtohen nga të rinjtë ose që punojnë me ta, mund të jenë burimet kyçe të qëndrueshmërisë së komunitetit. Të rinjtë, që përkufizohen përgjithësisht si njerëz midis 15 dhe 29 vjeç,¹ duhet të konsiderohen si aset dhe jo si problem: ata janë burim energjie, risie dhe kuraje dhe burim idesh të reja dhe qasjesh për fuqizimin e integritetit dhe pakësimin e rrezikut që paraqet krimi i organizuar.

Në raportin "*Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor*", të Iniciativës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), organizatat e rinisë janë identifikuar si lojtarët kyç për adresimin e dobësive ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.² Në këtë studim, do të shqyrtojmë veprimtaritë dhe mënyrat më të mira për fuqizimin e qëndrueshmërisë së rinisë, duke përfshirë edhe vënien në dukje të shembujve pozitivë.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore janë si më poshtë:

- Donatorët priren të përqendrohen te grupet ose problemet rinore në qytetet e mëdha, por të rinjtë në komunitetet rurale përballen me shumë sfida. OSHC-të në komunitetet e vogla mund të sjellin ndryshime të mëdha, por ato janë edhe më të ekspozuara. Ato kanë nevojë për mbështetje nga OSHC-të e tjera, donatorët dhe agjencitë qeveritare, të cilat mund të ndihmojnë me themelimin e OSHC-ve në vatrat e krimit të organizuar.
- Duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje krijimit të një kulture integriteti në shkolla dhe vënien në pah, për të rinjtë, të dëmeve që sjell korrupsioni dhe krimi i organizuar.
- Duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje parandalimit dhe trajtimit të dukurisë së përdorimit të drogës në radhët e të rinjve në Ballkanin Perëndimor.
- OSHC-të dhe influencuesit, si dhe njerëzit e respektuar të komunitetit dhe medias, duhet të zhvillojnë narrativa që i kundërvihen lavdërimit të krimit të organizuar, mashkullorësisë toksike dhe joshjes ndaj stilit të jetesës së "pasurimit të shpejtë".
- OSHC-të, agjencitë e krimit të organizuar dhe klubet e futbollit duhet të punojnë më ngushtë me njëri-tjetrin për të adresuar problemin e huliganizmit në futboll dhe lidhjet e tij me krimin e organizuar.
- OSHC-të, donatorët dhe agjencitë e zhvillimit duhet të bashkëpunojnë për të integruar elemente antikrim, në funksion të adresimit të nevojës së rinisë, brenda kuadrit të strategjive të hartuara për nxitjen e zhvillimit rural ose përmirësimin e lagjeve urbane.
- Ekziston nevoja për më shumë ndërveprim midis donatorëve, zyrtarëve qeveritarë, OSHC-ve dhe sektorit privat në drejtim të nxitjes së aftësimit profesional për aftësitë që kërkohen në treg dhe në sektorët ku ka mundësi punësimi. Një mënyrë për të përparuar është të krijohen ortakëri midis sektorit privat, shkollave dhe akademisë, me qëllim hartimin

OSHC-të në komunitetet e vogla mund të sjellin ndryshime të mëdha, por ato janë edhe më të ekspozuara. Ato kanë nevojë për mbështetje nga OSHC-të e tjera, donatorët dhe agjencitë qeveritare.

Shpesh donatorët nuk janë të informuar për OSHC-të që merren me problematikat e rinisë dhe anasjelltas.

e programeve të bashkuara, të orientuara nga biznesi, që do të përfshijnë të rinjtë, do të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe do të ofrojnë alternativa të prekshme ndaj krimit të organizuar.

- Ekziston nevoja për të ngritur ura midis agjencive qeveritare dhe OSHC-ve në funksion të përmirësimit të bashkëpunimit lidhur me veprimtaritë e qëndrueshme programatike për të ndihmuar të rinjtë e të rejtat në rrezik. Për shembull, të nxiten qeveritë për të punuar më ngushtë me OSHC-të që punojnë me të rinjtë nëpërmjet veprimtarive sportive ose kulturore, që ofrojnë këshillim dhe asistencë në luftën kundër varësisë nga droga dhe që angazhohen në mbështetjen paspenale.

- Duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje reformës paspenale dhe punës me autorët e rinj të veprave penale përpara se ata të lirohen nga burgu, me qëllim që të përmirësohet rishoqërimi dhe të ulet rreziku i recidivizmit.

Krahas kësaj, duhet të zhvillohen studime në vende ku ka një numër të madh të burgosurish nga Ballkani Perëndimor.

- Palët e interesuara duhet të përfshijnë një perspektivë gjinore në kuadër të punës së OSHC-ve lidhur me çështjet e të rinjve, duke përfshirë rolin dhe ndikimin te gratë, burrat dhe minoritetet seksuale dhe gjinore në hulumtimet shkencore dhe veprimtaritë e projektuara për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar.³

- Donatorët dhe qeveritë duhet të ndihmojnë organizatat e rinisë dhe OSHC-të që punojnë me rininë në Ballkanin Perëndimor, me qëllim fuqizimin e rrjeteve të tyre brenda rajonit, zhvillimin e njohurive praktike lidhur me mënyrën e aplikimit për grante më të mëdha dhe përmirësimin e aftësive të tyre në marketing.

- Qeveritë në Ballkanin Perëndimor duhet të përfitojnë më shumë nga ripërdorimi social i aseteve të rikuperuara, për të siguruar ambiente dhe mbështetje për veprimtari sportive, kulturore dhe shoqërore për rininë.

- Shpesh donatorët nuk janë të informuar për OSHC-të që merren me problematikat e të rinjve dhe anasjelltas. Mund të zhvillohet një takim vjetor ku OSHC-ve t'u jepet mundësia të japin prezantime për të bindur donatorët, për të shfaqur punën që kanë bërë dhe për të mësuar më shumë në lidhje me prioritetet e donatorëve.

- Të përfitohet nga statusi i Tiranës si "Kryeqyteti i Rinisë 2022" për të programuar veprimtari dhe fushata që fuqizojnë rininë në funksion të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit dhe rritjes së vetëdijesimit për krimin e organizuar.



Rinia është pjesë e motorit të inovacionit dhe rritjes ekonomike. © Qendra Rinore e Vlorës

HYRJE: PSE TË PËRQENDROHEMI TE RINIA?

Të rinjtë e të rejtat janë të cenueshme ndaj krimit të organizuar: edhe si autorë veprash penale, edhe si viktimë. Për disa njerëz, të rinjtë janë kërcënim: përdorues droge, huliganë ose "ushtarë terreni" për rrjetet e krimit të organizuar. Në fakt, në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor,⁴ të rinjtë e të rejtat janë konsumuesit më të mëdhenj të llojeve të caktuara të drogës (si kanabisi), janë të mbipërfaqësuar në burgjet e vendeve të tyre dhe jashtë vendit dhe përbëjnë pjesën kryesore të grupeve kriminale. Ata përfshihen në një shumëllojshmëri krimesh, p.sh. trafikimi i drogës, vjedhja e pronës (p.sh. vjedhja me thyerje dhe vjedhja e automjeteve), zhvatja dhe madje edhe vrasjet.

Por rinia është, gjithashtu, edhe pjesë e motorit të inovacionit dhe rritjes ekonomike. Ajo mund të jetë zëri i ndryshimit pozitiv në politikë dhe mund t'u sjellë komuniteteve jetë dhe energji. Më tej, ata përbëjnë një pjesë të madhe të popullsisë: rreth 20 deri në 25% të popullsisë së gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, ku 53% e qytetarëve kosovarë janë nën 25 vjeç.⁵

Për fat të keq, nëse pyet shumicën e të rinjve në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor lidhur me atë se çfarë duan të bëjnë në të ardhmen, përgjigja që do të marrësh është "të largohemi". Zhgënjimi nga polarizimi politik, korrupsioni, papunësia e madhe dhe mospërputhja midis asaj që mësohet në shkollë dhe aftësive që kërkohen në tregun e punës janë duke e zhgënjyer rininë.⁶ Edhe pse rajoni ka popullsi të re, ky potencial po humb në formën e "ikjes së trurit" dhe emigrimit ekonomik, duke qenë se shumë të rinj e të reja kërkojnë mundësi më të mira jashtë vendit. Sipas Forumit Ekonomik Botëror, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë disa prej normave më të larta në botë kur është fjala për "ikjen e trurit".⁷ Ca më keq akoma, disa të rinj në rajon e shohin krimin si shkurtore për të arritur pasuri, pozitë dhe pushtet.

Në këtë studim të shkurtër shqyrtohen faktorët e rrezikut që i bëjnë të rinjtë të dobët përpara krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor dhe reagimi nga shoqëria civile.



"Klub MASA" në Mostar e bën rininë pjesë të fushatave publike nëpërmjet veprimeve në rrugë, në disa qytete. © Klub MASA Mostar



Të rinjtë e të rejtat janë të cenueshme ndaj krimit të organizuar: edhe si autorë veprash penale, edhe si viktime. © Bahrudin Bandic

RREZIKU DHE CENUESHMËRIA

Duke u nisur nga perspektivat e bashkëndara të OSHC-ve që punojnë me të rinjtë në rrezik dhe nga takimet në fokus grupe të zhvilluara me të rinjtë e të rejtat, janë identifikuar një numër rreziqesh dhe sfidash që i bëjnë të rinjtë të dobët ndaj krimit të organizuar. Megjithatë, rrallë ndodh që cenueshmëria ndaj krimit të krijohet vetëm nga një faktor. Grupet kriminale shfrytëzojnë këtë cenueshmëri të të rinjve, të cilët kanë më shumë të ngjarë të marrin dënime më të ulëta.



KORRUPSIONI

Të rinjtë ndiejnë njëfarë apatie dhe pafuqishmërie, që vjen sepse rriten në një ambient me papunësi të lartë dhe korrupsion të përhapur. OSHC-të që punojnë me të rinjtë, ose iu referuan pasivitetit të këtyre të fundit, cinizmit dhe dëshirës së tyre për t'u larguar, ose dëshirës së tyre për ndryshim rrënjësor. Shumë prej të rinjve me të cilët kemi folur u shprehën se kishin nivel të ulët besimi në institucionet publike dhe në pjesëmarrjen në proceset demokratike si dhe mungesë të aftësisë për veprim.



Ekziston kultura e korrupsionit ku shkelja e ligjit, në vend që të ndëshkohet, shpërblehet.

Gjithashtu, ata ndiheshin të pafuqishëm në ekosistemin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, ku figurat e fuqishme veprojnë pa u ndëshkuar. Kjo i bën të rinjtë ambiciozë të ndiejnë se sistemi është i manipuluar, që kleptokracia ka përparësi ndaj meritokracisë dhe që nuk ka drejtësi. Një i anketuar u shpreh:

E vetmja gjë që shoh si rrugëdalje të mundshme është të iki nga ky vend, qoftë në rrugë të ligjshme, qoftë të paligjshme. Ndonjëherë, as që dua t'ia di fare. I gjithë vendi funksionon në bazë të korrupsionit. Kriminelët bëjnë jetë të mirë, ndërsa ne harxhojmë gjysmën e jetës për të marrë një diplomë. Po e humb shpresën se do të qëndroj këtu. Edhe po të gjej ndonjë punë, do ta kem të vështirë të mbijetoj. As që e mendoj të blej shtëpi ose të krijoj familje. Por po të merresha me shitje droge, të fitoja ca para, edhe po të më fusnin në burg për ca kohë, prapëseprapë do të kisha shumë kohë përpara për ta shijuar jetën.⁸

Përfaqësuesit e OSHC-ve dhe të rinjtë shpjeguan efektin paralizues dhe demoralizues që ka korrupsioni në shoqëri, duke përfshirë këtu edhe të rinjtë e të rejtat. Ai mund të jetë në formën e korrupsionit politik sistemik e deri te ryshfeti i përditshëm që duhet dhënë për të marrë shërbimin e duhur mjekësor, ndonjë vend pune në sektorin publik, për të kaluar ndonjë provim ose për të siguruar ndonjë leje ndërtimi. Por këto janë vetëm disa shembuj.⁹ Kjo kontribuon në një kulturë korrupsioni ku shkelja e ligjit, në vend që të ndëshkohet, shpërblehet. Siç paralajmëroi një përfaqësues i një OSHC-je në Bosnjë dhe Hercegovinë: "Me kalimin e kohës, ajo shoqëri që humb besimin te policia dhe qeveria dhe ndihet e pasigurt dhe e pambrojtur nga vetë shteti i saj, fillon të sillet si masë e pakontrolluar ku çdo gjë është e mundshme".¹⁰



ZHVILLIMI I PAMJAFTUESHËM

Në disa vende, pandemia "KOVID-19" ka rritur cenueshmërinë që paraqet zhvillimi i pamjaftueshëm, siç është papunësia e të rinjve ose punësimi në të zezë. Kjo situatë përkeqësohet nga mundësitë e pamjaftueshme arsimore që ofrohen në disa zona. Migrimi ka çuar në mbylljen ose reduktimin e shkollave fillore dhe të mesme, shkollave profesionale dhe universiteteve, dhe, për pasojë, mungesa e punësimit dhe mundësive për t'u arsimuar nxit emigrimin, brenda vendit ose jashtë tij. Të rinjtë— kryesisht burra—me arsim të kufizuar, përvojë pune të kufizuar ose aftësi profesionale jo të zhvilluara e kanë të vështirë të gjejnë punë të ligjshme jashtë vendit. Për këtë arsye, ata kanë më shumë të ngjarë të kërkojnë punë në të zezë, shpesh duke u dërguar kontrabandë në vende të tjera.

Situata është shumë më e vështirë në komunitetet ku fëmijët dhe të rinjtë janë aq të varfër, saqë bëhen viktimat e punës së detyruar ose shfrytëzimit seksual. Cenueshmëria është veçanërisht e lartë në disa komunitete rome.¹¹ Krahës kësaj, të rinjtë që janë pjesë e prurjeve të përziera migratore në rajon janë të dobët edhe ndaj shfrytëzimit ose përfshirjes si kontrabandistë.

Mundësitë e pakta për të nxënë aftësi për të cilat ka kërkesë në treg (për shembull, teknologji informacioni ose aftësim profesional) janë një tjetër rrezik. Të rinjtë pa aftësim profesional dhe të papunësuar, që shpesh janë të detyruar të sjellin të ardhura ose që thjesht kërkojnë shkurtore për të jetuar si pasanikë, mund të bien pre e kriminalitetit, kumarit ose kredive me interesa shumë të larta dhe përdorimit të drogës. Gjithashtu, ata mund të migrojnë jashtë vendit, ku bien në kurthin vicioz të krimit, p.sh. duke u marrë me ujitjen e bimëve të kanabisit në sera, duke bërë roje, duke marrë pjesë në vjedhjet e banesave ose duke shitur drogë.

Të rinjtë e të rejtat e paaftësuar dhe të papunësuar mund të bien pre e kriminalitetit, përdorimit të drogës, kumarit ose kredive grabitqare.



ASHENSORI I KRIMIT

REALITETI NË DESTINACION

- Skllavëri borxhi
- Jetë krimineli
- Mosintegrim në shoqëri
- Burgosje më të gjata
- Shfrytëzim në punë
- Arrestim ose deportim
- Skllavëri moderne

FAKTORËT TËRHEQËS

- Premtimi për pasurim të shpejtë dhe ngritje të statusit shoqëror
- Rreziqet më të ulëta të burgosjes dhe dënimet relativisht të shkurtra
- Besimi në një të ardhme më të mirë dhe në mundësi për punë të ligjshme

FAKTORËT SHTYTËS

- Mungesa e vendeve të lira të punës
- Rol-modelet e dhunshme dhe devijuese
- Numri i lartë i punëtorëve të patrajnuar
- Mungesa e arsimit
- Varfëria
- Mungesa e perspektivës



MJEDISET E DHUNSHME

Të rinjtë që rriten në familje jofunksionale, që kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje ose që kanë ndonjë prind me probleme varësie, shpesh janë të prirur të imitojnë ato sjellje ose të kenë vetëvlerësim të ulët ose probleme të shëndetit mendor. Kjo mund të ketë pasoja afatgjata sjellore dhe psikologjike. Më tej, kur një i ri ose e re rritet në një ambient ku krimi i organizuar dhe dhuna janë të përhapura, ai/ajo fillon t'i shohë modelet e sjelljes agresive si gjë normale. Siç u shpreh një përfaqësues i një OSHC-je, kjo mund të sjellë një "përmbysje të vlerave: ngritjen në qiell të krimit, dhunës dhe pandershmërisë, në vend të ndershmërisë, nderit dhe traditës".¹²

Në disa raste, të rinjtë rriten në vatrat e krimit të organizuar. Në komunitete të atilla, dhuna—duke përfshirë gjuajtjet me armë dhe bombardimet—nuk është gjë e pazakontë. Kriminelët kanë profil të lartë, ndërsa veprimtaritë e trafikimit dhe kontrabandimit dihen nga të gjithë. Policia konsiderohet si joefektive ose, madje, edhe si pjesë e problemit. Ndonjëherë ekzistenca e këtyre formave të kriminalitetit të organizuar shihet—edhe pse me ngurrim—si e pranueshme dhe e justifikuar. Në këto mjedise, krimi i organizuar shihet nga disa si një prej pak mënyrave për të fituar të ardhura të mjaftueshme. Roli i grupeve kriminale konsiderohet se është aq i fuqishëm dhe i gërshetuar me shtetin dhe qeverinë lokale sa që është e vështirë të dallosh veprimtaritë kriminale nga ato jokriminale. Aty ku ka një mjedis të fuqishëm kriminal dhe pak mjete të ligjshme për të nxjerrë jetesën, krimi i organizuar konsiderohet si "rrugëdalje".

Edhe në komunitetet që nuk janë vatra të krimit të organizuar, gjërat që mund të bëjnë të rinjtë shpeshherë janë të pakta. Shumë OSHC që punojnë me rininë—si dhe vetë të rinjtë e të rejt—kanë vënë në dukje mungesën e kinemave, ambienteve sportive, teatrove dhe qendrave rinore. "Qytetet bien të flenë në orën 4," tha një përfaqësues i një OJQ-je në Shqipëri për të nënkuptuar se jeta kulturore dhe artistike pothuaj nuk ekziston fare.¹³ Kjo situatë mund të çojë në delikuencë të të miturve, mungesë ndërveprimi shoqëror pozitiv dhe dobësim të ndjesisë së të qenurit pjesë e komunitetit. Kjo gjendje mund të shkaktojë edhe mërzë dhe frustrim dhe mund të çojë edhe në përdorimin e drogave ose përfshirjen në sherre, në krime kundër pronës dhe huliganizëm në futboll. Të pyetur se çfarë i shtynte të rinjtë për t'u bërë pjesë e krimit të organizuar, disa të anketuar në Mostar u përgjigjën thjesht: "Adrenalina".

Aty ku ka një mjedis të fuqishëm kriminal dhe pak mjete të ligjshme për të nxjerrë jetesën, krimi i organizuar konsiderohet si "rrugëdalje".



PËRJASHTIMI SOCIAL

Në disa raste, cenueshmëria vjen si rezultat i përjashtimit social, për shembull për shkak të prejardhjes etnike, ekonomike ose arsimore të personit të ri. Një aktivist në Bosnjë dhe Hercegovinë u shpreh se disa të rinj, që ndihen të përjashtuar nga shoqëria, "i shohin veprimtaritë kriminale si të vetmen mënyrë përmes së cilës mendojnë se mund pranohen nga të tjerët".¹⁴ Ndjenja e përkatësisë citohej shpesh si shkak i anëtarësimit në grupet e huliganëve ose krimit të organizuar, sidomos në radhët e të rinjve (meshkuj). Grupet kriminale u japin të rinjve ndjesinë e përkatësisë dhe identitetit, për të cilën këta kanë nevojë të madhe. Duke u bërë pjesë e një bande ose grupi kriminal, i riu i cenueshëm bëhet anëtar i një grupi të barabartësh me të. Ai fiton një identitet të qartë personal dhe shoqëror dhe më shumë pavarësi nga prindërit ose kujdestarët. Ai fiton siguri psikosociale dhe vetëbesim, një "rrugë drejt burrërisë" për të dhe një mënyrë me anë të së cilës ai mund të përmirësojë pozitën e vet shoqërore.¹⁵

Stereotipat kulturorë të figurave të fuqishme mashkullore dhe imazhet e të rinjve me para fizike, armë, gra dhe makina të shtrenjta, krijojnë rol-modele tërheqëse. Disa të rinj mendojnë se, duke u asociuar me këta njerëz, ata do të rrisin pozitën dhe statusin e tyre në shoqëri, të paktën midis bashkëmoshatarëve të tyre. Një përfaqësues i OSHC-së në Bosnjë dhe Hercegovinë tha: "Gjatë viteve të fundit ka një prirej për të bërë të pranueshëm përdorimin e substancave psikoaktive, alkoolizmin, stilin e jetesës prej kriminelit, huliganizmin, prostitucionin etj. E gjithë kjo çon në rritjen e numrit të të rinjve [që merren me veprimtari kriminale]."¹⁶ Rol-modelet devijante, që janë të përfshira në krimin e organizuar ose që mburren me stilin e jetesës së "pasurimit të shpejtë", mund të jenë tërheqëse për të rinjtë që ndikohen lehtë. Një i intervistuar theksoi: "Është shumë e lehtë të mësohesh me fitime të shpejta dhe shpenzime të mëdha dhe është shumë e vështirë të kthehesh prapa."¹⁷

Megjithatë, pjesë e krimit nuk bëhen vetëm fëmijët me prejardhje të pafavorshme. Përfaqësuesi i një OSHC-je në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut tha ka të rinj që vijnë nga familje të pasura dhe që merren me veprimtari kriminale për t'u mburrur dhe për t'u revoltuar kundër prindërve.¹⁸ Ka edhe raste, për shembull, në Serbi, ku fëmijë të vegjël, nga familje të pasura, janë bërë pjesë e grupeve të huliganëve.

Në një rajon ku droga sigurohet lehtë dhe është e lirë, përdorimi i drogës po fillon të bëhet problem, sidomos te fëmijët e moshës shkollare dhe te të rinjtë. Përdorimi i kanabisit është veçanërisht i përhapur te djemtë dhe vajzat në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ku është duke i rritur edhe përdorimi i drogave sintetike dhe i kokainës, sidomos gjatë fundjavave, festivaleve dhe në stinën e verës.¹⁹ Në disa raste, të rinjtë transportojnë drogë për të blerë drogën që e konsumojnë vetë. Trajtimi i varësisë nga droga në vendet e Ballkanit Perëndimor është i pamjaftueshëm dhe ka për qëllim kryesor thjesht uljen e dëmit dhe dhënien e trajtimeve me opiate zëvendësuese dhe jo trajtimin për varësinë nga kanabisi, kokaina ose drogat sintetike.

Gjithashtu, ka një mungesë mbështetjeje psikosociale për rehabilitim dhe rishoqërim, ndërsa përdorimi i drogës dhe trajtimi i varësisë nga droga shpesh stigmatizohet. Një OJQ në Maqedoninë e Veriut, e cila u ofron mbështetje përdoruesve që kanë varësi nga droga, vuri në dukje se të rinjtë që përdorin drogë ose që trajtohen për varësi nga droga "[...] e kanë shumë herë më të vështirë të punësohen. Ata përballen me stigmatizim dhe diskriminim gjatë procesit të marrjes në vendin e punës. Ata shpesh e humbin vendin e punës pasi merret vesh që janë duke u trajtuar ose që janë trajtuar më përpara për shkak të varësisë."²⁰ Po ashtu, të rinjtë që kanë qenë në burg—ose në atdhe, ose jashtë vendit—shpesh e kanë të vështirë të riintegrohen në shoqëri pas daljes nga burgu, gjë që mund të çojë në një spirale teposhtë për shkak të mungesës së mbështetjes paspenale.



OSHC-TË RINORE

Lipset të bëhet një dallim midis OSHC-ve që merren me çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë dhe OSHC-ve rinore. Këto të fundit mund të merren me disa prej çështjeve me të cilat merren edhe OSHC-të e tjera nëpërmjet mbështetjes midis të barabartëve (peer-to-peer). Megjithatë, ato mund të mbulojnë edhe çështje të tjera si korrupsioni, krimi mjedisor, liria e medias dhe gazetaria investigative dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Të gjitha këto paraqesin interes për të rinjtë, por nuk kanë të bëjnë vetëm me ta. Këto grupe, ndonjëherë, mund të shihen si grupe politike nga qeveritë dhe jo thjesht si organizata që ofrojnë shërbime për të mbështetur të rinjtë e të rejtat. Fuqizimi i rinisë mund të konsiderohet si kërcënim për disa qeveri, të cilat i shohin këta të rinj që ngrenë zërin, si "antiqueveritarë" dhe jo thjesht si "joqeveritarë".

OSHC-të që drejtohen nga të rinjtë, në përgjithësi, e shohin veten më shumë si "të rinj që merren me çështje që i prekin ata si qytetarë" dhe jo si "organizata që kanë për qëllim të përqendrohen te problemet e rinisë". Për pasojë, këto organizata shpesh janë kritike ndaj mungesës së përfshirjes së tyre në proceset e konsultimit ose ndaj angazhimit të disa të rinjve (që shpesh sponsorizohen nga qeveritë) si persona të caktuar për të qenë përfaqësues të të rinjve. Më tej, u vu në dukje, nga një numër të rinjsh në intervista dhe diskutimet në fokus grupe, se është e gabuar të ndjekësh një qasje të tipit "një masë u përshtatet të gjithëve" kur është fjala për shqetësimet e të rinjve në një vend ose rajon të caktuar, duke qenë se kushtet dhe nevojat ndryshojnë nga njëri komunitet në tjetrin.

Gjithashtu, u vu në dukje edhe se palët e interesuara shpesh mendojnë se e dinë për çfarë kanë nevojë të rinjtë pa i pyetur fare këta të fundit. Një i ri nga Mostari u shpreh: "Të gjithë bëjnë supozime lidhur me gjërat për të cilat ne kemi nevojë dhe të gjithë mendojnë se prirjet në Mostar janë të njëjta edhe në Sarajevë, Banja Lukë ose në ndonjë qytet tjetër të Ballkanit". Një tjetër u shpreh: "Nëse dëshironi ta angazhoni rininë, nuk mund të punoni gjithmonë me të njëjtët njerëz, të njëjtat shkolla ose të zgjidhni vetëm nxënësit e mirë. Për mendimin tim, në shumicën e rasteve, projektet bëhen për shkak të interesave të donatorëve dhe jo për ata që supozohet se janë qëllimi i projektit të tyre".²¹

**Të rinjtë kanë
nevojë për shtigje
alternative me
qëllim që t'i bëjnë
ballë krimit të
organizuar.**

Si të rinjtë, ashtu edhe të rejtat, janë të cenueshme ndaj krimit të organizuar. Një përfaqësues i një OSHC-je në Vlorë të Shqipërisë vuri në dukje: "Të rinjtë janë më të ekspozuar ndaj rrezikut të përfshirjes në këto veprimtari, për shkak të mendësisë së shoqërisë sonë, e cila i shtyn burrat të marrin përsipër barrën e fitimit të të ardhurave për të mbajtur shtëpinë, ndërsa të rejtat shpesh i marrin këto rreziqe mbi supe për të mbështetur partnerët e tyre ose kur nuk kanë dikë ku të mbështeten".²² Një përfaqësues nga një OSHC në Bosnjë dhe Hercegovinë, e cila punon me të rinjtë, bëri këtë koment: "Ka disa tipa personalitetesh femra që kanë më shumë të ngjarë të bëhen kriminele sepse diçka e tillë do të ishte "mekanizëm mbrojtjeje" kundër qenies viktimë e krimit. Logjika e disa të rejave me të cilat ajo punon është: "është më mirë të jesh kriminele sesa viktimë e kriminelëve të tjerë".²³ Megjithatë, me ndryshimin e roleve tradicionale gjinore në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor, është e mundshme që emancipimi i grave të manifestohet edhe në rritjen e numrit të grave që kanë role drejtuese në grupet e krimit të organizuar.²⁴

Ndërkohë që numri i njerëzve që kalojnë kohë në internet sa vjen e rritet, të rinjtë, sidomos fëmijët, mund të bien pre e "zhvatjes seksuale" ose shfrytëzimit seksual komercial në internet. Të rinjtë nuk janë vetëm viktima të krimeve kibernetike ose krimeve që mundësohen nga interneti, por mund të jenë edhe autorë krimi, për shembull, hackerë, që zhvatin shërbime seksuale, kryejnë mashtrime me kriptovaluta, përdorin ransomuerë ose nxjerrin kriptovaluta (që nuk është krim në vetvete, por krim është vjedhja e energjisë elektrike për të nxjerrë kriptovalutat).

Duke mbajtur parasysh këto rreziqe dhe dobësi, rinia ka nevojë për shtigje alternative. "Ata kanë nevojë që t'u dëgjohet zëri dhe të përfshihen në procese demokratike me qëllim që t'i bëjnë ballë asaj që ofron krimi i organizuar", tha përfaqësuesi i një OSHC-je në Vlorë të Shqipërisë.²⁵ Sikurse tregohet në pjesën radhës, ekziston një numër OSHC-sh në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat u ofrojnë mbështetje të rinjve që të gjejnë këto shtigje dhe t'i bëjnë ballë krimit të organizuar.



Nuk janë të shumta OSHC-të në Ballkanin Perëndimor që përqendrohen te krimi i organizuar, por edhe më të pakta janë ato që adresojnë dobësinë e rinisë ndaj krimit të organizuar. © Juventas

VEPRIMTARITË E OSHC-VE QË MERREN ME ÇËSHTJET E RINISË

Nuk janë të shumta OSHC-të në Ballkanin Perëndimor që përqendrohen te krimi i organizuar, por edhe më të pakta janë ato që adresojnë dobësinë e rinisë ndaj krimit të organizuar. Megjithatë, një numër OSHC-sh në rajon punojnë për uljen e rreziqeve dhe dobësive të përshkruara në pjesën e mëparshme. Për pasojë, puna e tyre ndihmon me rritjen e aftësisë së rinisë për t'i bërë ballë krimit të organizuar. Kjo bëhet në mënyra të ndryshme, disa prej të cilave janë:

- mbrojtja, fuqizimi dhe integrimi i të rinjve e të reja;
- ofrimi i arsimit, rritja e vetëdijesimit, aftësimi për punë dhe mbështetja për biznese sociale;
- krijimi i një hapësire të sigurt për veprimtari sportive dhe kulturore;
- ofrimi i rol-modeleve pozitive dhe mentorimit;
- puna me parandalimin dhe trajtimin e varësisë nga droga;
- ofrimi i ndihmës paspenale.

Me buxhete relativisht të vogla, OSHC-të që punojnë në këtë fushë kryejnë kërkime shkencore, ofrojnë rekomandime qeverive lokale, organizojnë fushata dhe trajnime, konferenca dhe seminare praktike (uorkshope). Gjithashtu, ato organizojnë edhe veprimtari për të angazhuar të rinjtë në mënyra të tilla që i fuqizojnë dhe i mbajnë ata larg grupeve kriminale. Ato punojnë në qytete të mëdha, por edhe në komunitete të vogla, duke përfshirë këtu edhe komunitetet që janë vatra të krimit të organizuar.²⁶

Në këtë pjesë, do të shohim me më shumë hollësi disa prej këtyre veprimtarive, duke u mbështetur në punën e OSHC-ve që marrin mbështetje nga Fondi i Qëndrueshmërisë të GI-TOC-së, të cilat kanë marrë pjesë në "Dialogët për qëndrueshmërinë" të GI-TOC-së ose që janë pjesë e rrjetit rajonal të shoqërive civile Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore të GI-TOC-së.



FUQIZIMI DHE

INTEGRIMI

OSHC-të fuqizojnë kohezionin shoqëror duke punuar me të rinjtë që rrezikojnë përjashtimin shoqëror.

Sikurse vumë në dukje më sipër, disa të rinj ndihen të përjashtuar ose të zhgënjyer lidhur me mundësitë e tyre në të ardhmen dhe aftësitë e tyre për të sjellë ndryshim në jetën ose komunitetet e tyre. Kjo rrit gjasat që ata të braktisin shkollën, të provojnë drogën dhe të bien në grackën e krimit. OSHC-të përpiqen të përforcojnë kohezionin social duke punuar me të rinj e të reja që janë të cënueshme ndaj përjashtimit social dhe duke i bashkuar ata me bashkëmoshatarët e tyre për të kryer veprimtari të përbashkëta, ku përfshihen: zhvillimi i dialogëve rreth temave që përbëjnë interes të përbashkët, kampet verore, veprimtaritë sportive dhe kulturore dhe angazhimi i tyre në punën dhe jetën e komunitetit. Kjo ndihmon për të fuqizuar ndjenjat e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit.

Disa OSHC janë përpjekur të shpjegojnë rreziqet e krimit të organizuar dhe të shfronësojnë mitin e stilit të jetesës së "pasurimit të shpejtë". Një prej tyre, OSHC-ja "Together for Life" në Tiranë të Shqipërisë, ka nisur një projekt në Dibër për të rritur vetëdijesimin e të rinjve lidhur me rreziqet e krimit të organizuar. Ajo krijon edhe lidhje midis të rinjve e të rejave dhe bizneseve lokale për të siguruar mundësi trajnimi dhe punësimi. Një tjetër OSHC shqiptare, "Epoka e Re", me seli në Fier, organizon klube sociale për rininë dhe ditë informative për prindërit, për të rritur vetëdijesimin lidhur me rreziqet që ndërlidhen me krimin e organizuar. Krahës kësaj, organizata "Community Building Mitrovica" në Kosovë zhvilloi një fushatë të profilit të lartë për të paralajmëruar të rinjtë e të reja lidhur me rrezikun e trafikimit të qenieve njerëzore.

Ka një numër shembujsh të mirë OSHC-sh që theksojnë fuqishëm parandalimin dhe mbrojtjen. Për shembull, një OSHC në Shtip të Maqedonisë së Veriut punon për të parandaluar dhe kallëzuar dhunën kundër fëmijëve dhe rinisë. Ajo merret edhe me parandalimin e radikalizimit të dhunshëm të të rinjve dhe me kundërveprimin ndaj rekrutimit dhe abuzimit të fëmijëve dhe rinisë nga krimi i organizuar. "Klub Masa" në Mostar të Bosnjës dhe Hercegovinës zbaton programe për t'i larguar të rinjtë e të rejt nga huliganizmi i futbollit, i cili mund të shërbejë edhe si pikë hyrjeje për krimin e organizuar. T'u ndihmojmë fëmijëve (Pomozimo Djeci) në Banja Lukë të Republikës Serbe punon me të rinjtë në moshë të hershme për të parandaluar delikuecën e të miturve. Krahas kësaj, OSHC-të në veri dhe jug të Shqipërisë kanë zhvilluar fushata për rritjen e vetëdijesimit për rreziqet e kultivimit të kanabisit.

Në raste të tjera, OSHC-të përpiqen të luftojnë kundër pafuqishmërisë së mësuar dhe apatisë, duke i nxitur të rinjtë e të rejt që të ndërmarrin një rol më aktiv në jetën e komuniteteve të tyre. Një shembull i mirë vjen nga Qendra Rinore e Vlorës, në jug të Shqipërisë. Në kuadër të punës së saj bën pjesë përmirësimi i demokracisë vendore, nxitja e përfshirjes së rinisë dhe qëndrueshmërisë së komunitetit dhe buxhetimi pjesëmarrës. Në Shkodër të Shqipërisë gjejmë një tjetër shembull: klubin e arteve marcialë që trajnon të rinj e të reja për t'u bërë qytetarë më aktivë. Një përfaqësuese e një OSHC-je në Mostar u shpreh: "Ka një masë të madhe të rinjsh e të rejash që duan me të madhe të jenë aktivë në këtë shoqëri pasive, por nuk dinë se si. Është shumë e rëndësishme t'u tregojmë të rinjve, përmes arsimit joformal, se si mund të angazhohen në komunitet."²⁷

Në komunitetet ku ka tensione etnike, disa OSHC kërkojnë të nxisin dialogun, të ofrojnë alternativa ndaj pikëpamjeve ekstremiste ose nacionaliste dhe t'i mbajnë të rinjtë larg dhunës. "Klub Masa", për shembull, nxit dialogun ndëretik në punën e tij në luftën kundër huliganizmit në futboll. Në projektin e parë të këtij lloji, OSHC-ja "Community Building Mitrovica" ndërmori nismën për rritjen e vetëdijesimit për trafikimin e qenieve njerëzore, në të cilën morën pjesë të rinj shqiptarë dhe serbë etnikë nga të dy anët e lumit Ibër. Një OSHC në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut nxit dialogun ndërkulturor dhe kuptimin e drejt të diversitetit kulturor duke organizuar veprimtari artistike në fusha si piktura, fotografia, teatri dhe kinematografia. "Projektet [tona] përqendrohen te shkatërrimi i paragjytimeve dhe stereotipave, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe promovimi i kulturës, diversitetit dhe traditës", tha përfaqësuesi.²⁸

Në shumë komunitete të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, të rinjtë e të rejt kanë mendim jo të mirë për policinë dhe institucionet shtetërore. Disa OSHC, si "Sebastia" në Kurbin të Shqipërisë, kanë ndërmarrë nismën për të rritur besimin tek institucionet e zbatimit të ligjit dhe ato publike, nëpërmjet organizimit të tryezave të rrumbullakëta, trajnimeve dhe shfaqjeve artistike.

Në dialogët për qëndrueshmërinë, të zhvilluar nga GI-TOC-ja në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, organizatat rinore dhe OSHC-të që merren me çështjet e të rinjve morën pjesë në dialogë

me përfaqësues të qeverisë, në përpjekje për të ngritur ura bashkëpunimi. Ekziston hapësira për ndjeshmëri më të madhe ndaj problematikave të rinisë në kuadër të policimit në komunitet si dhe nevoja që institucionet publike dhe qeveria lokale të reagojnë në mënyrë më efektive ndaj nevojave të të rinjve e të rejave dhe të komunikojnë me ta në mënyrë më proaktive. Në veçanti, policia duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje parandalimit të krimit në bashkëpunim me OSHC-të dhe grupet e tjera të komunitetit, dhe ta përshtatë punën e saj duke marrë për bazë analizën e hollësishme të informacioneve lidhur me gjendjen vendore.



ARSIMIMI DHE TRAJNIMI

Një prej dobësive që u vunë në dukje nga shumë OSHC është ekzistenca e një shpërputhjeje midis sistemit arsimor dhe tregut të punës dhe mungesa e aftësimit profesional për të rinjtë e të rejat. Disa OSHC synojnë ta mbyllin këtë hendek duke u ofruar të rinjve mundësi për të mësuar aftësi të reja, për qëllime të ndryshme, duke përfshirë ekspozimin më efikas dhe luftimit të krimit të organizuar. Për shembull, OSHC-ja "Mladiinfo", me seli në Niksiç të Malit të Zi, mbështet të rinjtë e të rejat që dëshirojnë të merren me gazetari, duke përfshirë këtu edhe gazetarinë investigative rreth krimit të organizuar dhe korrupsionit. Një tjetër shembull është edhe Qendra Rinore e Vlorës, e cila ka mbi 20 vjet që punon me të rinj e të reja për të zgjeruar horizontet e tyre, aftësitë dhe mundësitë duke i përkrahur ata që të gjejnë mënyra të ligjshme për sigurimin e jetesës.²⁹

Ka një shpërputhje midis sistemit arsimor dhe tregut të punës dhe një mungesë të aftësimit profesional për të rinjtë e të rejat.

Disa OSHC i ofrojnë trajnime personelit të ri ose vullnetarëve në lidhje me menaxhimin e projekteve, zhvillimin e fushatave të vetëdijesimit të publikut, avokimin, krijimin e koalicioneve, mobilizimin e burimeve dhe aftësive të prezantimit. Për shembull, OSHC-ja "Juventas" në Mal të Zi i përfshin të rinjtë e të rejat në procesin e hartimit dhe zbatimit të projekteve që kanë për objektiv fuqizimin e kapaciteteve të të rinjve, duke përfshirë nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët universitarë, vullnetarët dhe punonjësit që punojnë me të rinjtë.

Megjithatë, ekziston nevoja për mbështetje të mëtejshme për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve që merren me problematikat që kanë të bëjnë me krimin e organizuar.



Të rinjtë diskutojnë dëmet e drogës në komunitetin e tyre në Maqedoninë e Veriut. © Double Hope

Një tjetër ide që ia vlen të shqyrtohet është zhvillimi i "portaleve të ndikimit" me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit të të rinjtë, si dhe krijimi i hapësirave për mentorim, rrjetëzim dhe shkëmbim aftësish dhe burimesh. Një shembull është edhe projekti i përbashkët i Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe Agjencisë Austriake për Promovimin e Kërkimit Shkencor, i cili ka për qëllim eksplorimin e mundësive për zbatimin e një skeme të re financimi për inxhinierinë e kursimit në Ballkanin Perëndimor.³⁰

PROMOVIMI I VEPRIMTARIVE SPORTIVE DHE KULTURORE

Një problem që u përmend herë pas here nga OSHC-të që mbështesin të rinjtë—dhe atyre që drejtohen nga të rinjtë—është mungesa e ambienteve sportive dhe veprimtarive kulturore për të rinjtë në rajon. "Në qytet nuk ka kinema. Ka vetëm disa ngjarje kulturore. Nga ana tjetër, të rinjtë ndiejnë presionin e vazhdueshëm për t'u anëtarësuar në ndonjë parti politike. Politika është bërë e pranishme në çdo sferë të jetës sonë, dhe kjo gjë është tepër zhgënjyese për të rinjtë", u shpreh përfaqësuesi i një OSHC-je në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut.³¹

Biblioteka "KinFolk Coffee Library" në Durrës përqendrohet tek ofrimi i një shumëllojshmërie aktiviteteve për rininë. Kjo qendër, e cila është pronë që iu sekuestrua një grupi kriminal, është kthyer në kafene që funksionon si qendër shumëkulturore ku ofrohen trajnime, kurse aktrimi, grupe diskutimi, kurse shahu dhe gjuhësh të huaja dhe ku zhvillohen shkolla verore dhe dimërore. OSHC-të mund të përdorin edhe sportin për të pakësuar cenueshmërinë ndaj krimit të organizuar, sikurse ka treguar klubi i arteve marciale në Shkodër të Shqipërisë. Atje, instruktorët punojnë me djemtë dhe vajzat për të fuqizuar disiplinën dhe vetëbesimin e tyre nëpërmjet taekwondosë, ndërkohë që u mësojnë se si t'u rrinë larg grupeve kriminale në qytet.

Hapësira të sigurt si këto krijojnë mundësi që të rinjtë e të rejtat të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, duke ndihmuar kështu në prishjen e roleve gjinore tradicionale dhe të stereotipave gjinorë. Këto hapësira shërbejnë edhe si vende ku të rinjtë e të rejtat mund të zhvillojnë interesat dhe vetëvlerësimin. Ka vend për angazhim më të madh të OSHC-ve dhe ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara për të siguruar ambiente sportive dhe qendra kulturore për të rinjtë e të rejtat në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.



OFRIMI I ROL-MODELEVE POZITIVE DHE MENTORIMIT

Siç kemi vënë në dukje më lart, të rinjtë shpesh nuk kanë rol-modele pozitive dhe mentorë. Në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, drejtuesit dhe personeli i OSHC-ve që merren me problematikën që mund të pakësojnë cenueshmërinë ndaj krimit të organizuar janë vetë rol-modele. Angazhimi qytetar, vullnetarizmi dhe lidhshëria i tyre janë shembull pozitiv për të rinjtë e të rejtat. Grupet e kishave dhe organizatat e shërbimeve si "Lions Club" dhe "Rotary International", të cilat gjenden në mbarë rajonin, mund të ofrojnë rol-modele të fuqishme duke zhvilluar njëkohësisht edhe veprimtari me të cilat përkrahet rinia në komunitet.

Ka edhe një numër shembujsh të mirë nga Shqipëria. Për shembull, OSHC-ja "Information Network and Active Citizenship" realizoi një projekt për të kuptuar faktorët që ndikojnë te rinia në vatrën e krimit në Elbasan dhe për të identifikuar rol-modelet pozitive që mund të bashkëndajnë përvojat, ekspertizën dhe vlerat e tyre me të rinjtë e të rejtat. Krahës kësaj, qendra rinore "Sebastia" në bashkinë e Kurbinit në Shqipëri po punon me të rinjtë e të rejtat për të luftuar kundër stereotipit të rajonit si vatrë e krimit të organizuar (sidomos për hajdutët e banesave që veprojnë në BE), dhe po u jep të rinjve e të rejave udhëzime për një jetë më të mirë.³²



Të rinjtë protestojnë për të ruajtur një pikë historike. Veprimtaria u organizua nga qendra rinore "Sebastia", organizatë e shoqërisë civile në Kurbin të Shqipërisë. © Qendra rinore "Sebastia"



QENDËR RINORE APO SHKOLLË KRIMI?

Në vitet e fundit, vjedhjet në shtëpitë e futbollistëve dhe personave të famshëm kanë qenë kryetitujt e gazetave në Spanjë dhe Itali. Shumë prej autorëve të krimeve janë të rinj shqiptarë nga i njëjti rajon i Shqipërisë: Kurbin, një bashki në veri të kryeqytetit shqiptar, Tiranës. Pas vitit 2010, kur u bë më e lehtë për shqiptarët që të udhëtonin brenda BE-së, hajdutët nga Kurbin përfituan nga rasti dhe u bënë famëkeq në mbarë Evropën. Media u vuri nofkën "skifterë" për shkak të shpejtësisë dhe aftësive të tyre grabitqare. Të rinjtë që kthehen nga "aventurat" e tyre jashtë shtetit, me makina të shtrenjta, veshje dhe bizhuteri, u bënë rol-modele për të rinjtë e varfër dhe të ndikueshëm të Kurbin, të cilët donin të bëheshin "të suksesshëm" si "heronjtë" e tyre të rinj. Deri nga viti 2015 dhe 2016, kjo dukuri u përhap aq shumë në këtë zonë, sa që disa të rinj braktisën shkollën për të shkuar jashtë shtetit dhe për t'u marrë me hajdutëri. Grabitësit me përvojë të banesave ua mësuuan aftësitë hajdutëve të rinj në atë që u bë "shkollë krimi". Për të ndihmuar me trajtimin e këtij problemi, një grup të rinjsh krijoi një OSHC që u quajt "Qendra Rinore "Sebastia"". Kjo organizatë, e cila është e vetmja në bashki, punon me të rinjtë e cenueshëm për t'u ofruar atyre rol-modele pozitive dhe mundësi që të angazhohen në veprimtari të ligjshme dhe të mësojnë aftësi të reja. Ajo përqendrohet në parandalimin e rekrutimit të të rinjve nga grupet kriminale dhe u ofron atyre një mundësi për t'u bërë anëtarë më aktivë të komunitetit.³³

Pjesë e të qenët rol-model pozitiv është edhe nxitja e barazisë gjinore, shmangia e stereotipave dhe adresimi i mashkullorësisë toksike, si dhe nxitja e tolerancës dhe respektit për të ndryshmen.³⁴ Kjo është temë që meriton më shumë vëmendje dhe mbështetje. Krahës kësaj, përfshirja e ish-të dënuarve ose ish-anëtarëve të grupeve kriminale në dialogët me të rinjtë ekspozon një anë jo aq të mahnitshme të krimit të organizuar dhe mund të ndihmojë për të komunikuar me të rinjtë që mund të refuzojnë të marrin pjesë në llojet më tradicionale të diskutimeve p.sh. në fokus grupe ose mentorim. Deri më tani, fare pak persona të famshëm, drejtues të komunitetit ose influencers janë angazhuar në fuqizimin e qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar. Ka potencial të pashfrytëzuar në këtë fushë për të kundërvepruar ndaj narrativave që ngrenë në qiell krimin dhe përdorimin e drogës.

PARANDALIMI I PËRDORIMIT TË DROGËS

Droga po përdoret gjithmonë e më shumë në Ballkanin Perëndimor, por trajtimi i varësisë nga ajo ka mbetur prapa.

Edhe pse droga po përdoret gjithmonë e më shumë në Ballkanin Perëndimor, trajtimi i varësisë nga droga duket se ka mbetur prapa. Shumica e qendrave dhe programeve të trajtimit të varësisë nga droga kanë për objektiv terapinë e zëvendësimit me opiate dhe reduktimin e dëmit, megjithatë përdorimi i heroinës është i vogël te të rinjtë në rajon, me përjashtim të komuniteteve romë në Shqipëri dhe Kosovë. Problemet kryesore janë me përdorimin e kanabisit, kokainës dhe drogave sintetike.

Një numër OSHC-sh në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor ofrojnë mbështetje për përdoruesit e drogave. Këtu përfshihen fushatat dhe informacionet për parandalimin e përdorimit të drogës (për shembull, në shkollat e mesme) dhe ndihma për përdoruesit e drogës që janë pjesë e komunitetit LGBT, si dhe shërbimet për uljen e përdorimit të drogës në radhët e punonjëseve të seksit, të burgosurve dhe komuniteteve të marginalizuara dhe minoriteteve si komuniteti romë. Shembuj janë "Juventas" në Mal të Zi, "HOPS" në Maqedoninë e Veriut dhe "Restart" në Serbi. Kjo punë është veçanërisht e rëndësishme për të thyer ciklin e të rinjve që përdorin droga dhe që më pas përfshihen në krimin e organizuar (edhe për të paguar për drogën) ose që përfshihen në krimin e organizuar dhe

pastaj fillojnë të përdorin drogë (siç është rasti i shitësve të drogës që bëhen përdorues të saj). OSHC si organizata "Restart" kanë vënë në dukje shembujt e të rinjve që po i nënshtrohen trajtimit dhe rehabilitimit për varësinë ndaj drogës, përpara se të jenë në gjendje të rishoqërizohen dhe riintegrohen me sukses në shoqëri. Të rinjtë që nisin këtë rrugëtim që të ndryshon jetën janë rol-modele me fuqi të veçantë në sytë e të rinjve që janë zënë në kurthin e ciklit të drogës dhe krimit, sepse ata mund të jenë burim i besueshëm që ofron mbështetje për të barabartët e tyre. Disa OSHC—madje edhe ato që nuk specializohen në trajtimin e varësisë nga droga—theksonin nevojën për më shumë edukim dhe informim në shkolla lidhur me efektet e dëmshme që kanë drogat dhe krimi.

Ndonëse marrëdhëniet midis OSHC-ve dhe agjencive qeveritare shpesh janë të tensionuara, ato janë shumë të mira kur është fjala për problemin e parandalimit dhe trajtimit të varësisë nga droga. Kjo ndodh ndoshta sepse OSHC-të që u ofrojnë mbështetje përdoruesve të drogave shihen nga qeveria si ofrues shërbimi që ndihmojnë për të adresuar mungesën e trajtimit, sidomos në vende që nuk kanë më qasje në mbështetjen nga Fondi Botëror, një organizatë ndërkombëtare që investon për të mbështetur programet e ekspertëve lokalë për të luftuar sëmundjet.



NDIHMA PASPENALE

Numri i të rinjve nga Ballkani Perëndimor që janë në burg në vendin e tyre ose jashtë vendit është mjaft i lartë.³⁵ Në disa raste, të rinjtë që janë futur në burgje për vepra penale relativisht të vogla takohen me kriminelë të rrahur me vaj e me uthull dhe rrezikojnë të përfundojnë jo vetëm si autorë përsëritës krimi, por edhe si kriminelë me pozitë më të lartë në shkallët e krimit, duke u mbështetur në përvojën dhe kontaktet që krijojnë në burg. Në Serbi, norma e recidivizmit është mbi 60%.

Për këtë arsye, ndihma paspenale është tejet e rëndësishme. OSHC-ja "Neostart" në Serbi ndihmon të burgosurit që lirohen nga burgu dhe u ofron atyre mbështetje që të kërkojnë për vende pune. Organizata u ofron trajnime për shkrimin e CV-ve dhe përgatitjen për intervistat e punës dhe konsultime, mbështetje psikologjike dhe udhëzime për të krijuar një atmosferë të shëndetshme në familje pas daljes nga burgu. Krahas kësaj, organizata "Neostart" mbështet edhe të rinjtë (kryesisht meshkuj që dalin nga institucioni korrektues në Krusevac ose nga burgu i të miturve në Valjevë. Në këtë mbështetje përfshihet ushqimi dhe akomodimi për të rinjtë e cënueshëm me qëllim parandalimin e recidivizmit, ndihmimi me përditësimin e dokumenteve të identitetit (të cilat shpesh mund të skadojnë gjatë periudhës së dënimit me burg) dhe mentorimi. Neostart-i ofron edhe seminare motivuese për përfshirjen sociale dhe riintegrimin pozitiv. Disa prej mentorëve të kësaj OSHC-je janë ish-kriminelë. Njëlloj si parandalimi dhe trajtimi i varësisë nga droga, ndihma paspenale për të rinjtë është një temë në lidhje me të cilën ka bashkëpunim relativisht të mirë midis OSHC-ve dhe agjencive qeveritare, por ekziston nevoja për mbështetje të mëtejshme financiare.



OJQ-ja "Community Building Mitrovica" ka ngritur vetëdijesimin e të rinjve e të rejave për mekanizmat kombëtarë dhe rajonalë për raportimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për kërkimin e ndihmës. © Community Building Mitrovica

ZHBLLOKIMI I POTENCIALEVE TË RINISË

Ndonëse OSHC-të në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë duke bërë punë të rëndësishme në drejtim të fuqizimit të qëndrueshmërisë së rinisë ndaj krimit të organizuar, ka vend për më shumë angazhim nga shoqëria civile. Një përfaqësues i OSHC-së në Bërçko të Bosnjës dhe Hercegovinës tha se: "Duhet të ketë më shumë përfshirje të sektorit të OJQ-ve, sidomos kur flasim për krimin e organizuar dhe parandalimin e tij, me qëllim që të rinjve t'u ofrohen programe cilësore ku të takohen me të rinj të tjerë, të udhëtojnë e të shoqërohen dhe të njihen si udhëheqës në komunitetet e tyre."³⁶


Ekziston hapësirë për fuqizimin e rrjeteve rajonale të të rinjve në Ballkanin Perëndimor, me qëllim rritjen e mirëkuptimit e bashkëpunimit dhe bashkimin e përpjekjeve në drejtim të përmirësimit të aftësisë për t'i bërë ballë krimit të organizuar. Këto përpjekje mund të kenë si themele punën e GI-TOC-së dhe programet ekzistues si Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (Regional Youth Cooperative Office) ose projektin "Laboratori Rinor i Ballkanit Perëndimor" i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (Regional Cooperation Council).³⁷

Të rinjtë e të rejtat janë çelësi për të pasur një Ballkan të qëndrueshëm, por ata rrezikojnë të bien pre e krimit të organizuar. Rritja e mbështetjes për OSHC-të që punojnë me rininë mund të çojë në çlirimin e potencialit të të rinjve e të rejave në rajon dhe t'i angazhojë ata në mënyrë më aktive në fuqizimin e qëndrueshmërisë së komuniteteve të tyre ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.

SHËNIME

- 1 Se cila grupmoshë konsiderohet "rini", kjo ndryshon sipas rastit, por për qëllime statistikore, në nivelin e BE-së, shpesh përzgjidhet grupmosha e personave nga 15 deri 29 vjeç. Shihni: Komisioni Evropian, Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social, dhe Komitetin e Rajoneve lidhur me zbatimin e "Strategjisë Evropiane të Rinisë (2019-2021)", 14 tetor 2021, https://europa.eu/youth/d8/sites/default/files/inline-files/1_EN_ACT_part1_v3.pdf.
- 2 Kristina Amerhauser dhe Walter Kemp, "Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, GI-TOC, shkurt 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/03/CSO-WBalkans1_ALBANIAN-WEB-2603.pdf.
- 3 Për më shumë informacione, shihni: Fatjona Mejdini dhe Kristina Amerhauser, Ballkani i Qëndrueshëm: Gjinia dhe krimi i organizuar, GI-TOC, shkurt 2022, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2022/02/GMFA-Gjinia-dhe-Krimi-i-Organizuar-ALBANIAN-WEB.pdf>.
- 4 Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor përfshin: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Referencat për Kosovën në këtë raport janë bërë pa cenuar pozicionet lidhur me statusin e vendit dhe janë në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e pavarësisë nga Kosova.
- 5 Komisioni Evropian, Asistenca e BE-së për Kosovën, Arsimi për të ardhmen, pa datë, https://eeas.europa.eu/archives/delegations/kosovo/documents/press_corner/education_for_the_future_en.pdf.
- 6 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Study on Youth Employment in the Western Balkans [Studim për punësimin e rinisë në Ballkanin Perëndimor], korrik 2021, <https://www.rcc.int/docs/573/study-on-youth-employment-in-the-western-balkans>.
- 7 Klaus Schwab, The global competitiveness report 2019 [Raporti botëror i konkurrencës për vitin 2019], Forumi Ekonomik Botëror, 2019, https://www3.weforum.org/docs/WEF_TheGlobalCompetitivenessReport2019.pdf; shihni edhe: Milica Stojanovic, Nearly half of Bosnia's youngsters pondering emigration [Pothuaj gjysma e të rinjve boshnjakë mendojnë të emigrojnë], BalkanInsight, 17 nëntor 2021, <https://balkaninsight.com/2021/11/17/nearly-half-of-bosnias-youngsters-pondering-emigration/>.
- 8 Pohim në një fokus grup me të rinjtë, i organizuar në Mostar të Bosnjës dhe Hercegovinës, tetor 2021.
- 9 Intervistë me një përfaqësues të Qendrës Rinore të Vlorës në Shqipëri, 26 nëntor 2021.
- 10 Intervistë me një përfaqësues të organizatës "Klub MASA" në Mostar të Bosnjës dhe Hercegovinës, 4 nëntor 2021.
- 11 Stephan Müller et al., Roma: Europe's neglected coronavirus victims [Romët: viktimat e neglizhuara të koronavirusit në Evropë], BalkanInsight, 1 prill 2020, <https://balkaninsight.com/2020/04/01/roma-europes-neglected-coronavirus-victims/>.
- 12 Intervistë me një përfaqësues të organizatës "Double Hope" në Shtip të Maqedonisë së Veriut, 27 tetor 2021.
- 13 Intervistë me Nensi Dragotin në Shqipëri, 28 nëntor 2021.
- 14 Intervistë me Xhanan Berberoviçin (Džanan Berberović), profesor i asociuar në Universitetin e Tuzlës dhe psikolog i autorëve të mitur dhe të rinj në institucionin korrektues-edukativ në Orasje të Bosnjës dhe Hercegovinës, 2 nëntor 2021.
- 15 DaJung Woo et al., Social psychology of gangs: An Intergroup Communication Perspective

- [Psikologjia sociale e bandave kriminale: Perspektivë e komunikimit ndërgrupor], në Scott H Decker dhe David C Pyrooz (redaktorë), *The Handbook of Gangs*. John Wiley dhe Sons, 2015, https://www.researchgate.net/publication/305355348_Social_Psychology_of_Gangs_An_Intergroup_Communication_Perspective.
- 16 Intervistë me Ela Ljubiçin (Ella Ljubić) në Bosnjë dhe Hercegovinë, 4 nëntor 2021.
 - 17 Fokus grup me të rinjtë në Mostar të Bosnjës dhe Hercegovinës, 15 tetor 2021.
 - 18 Intervistë me një përfaqësues të shoqatës për të rinjtë "Kreator" (Youth Association Kreator) në Maqedoninë e Veriut, 27 tetor 2021.
 - 19 Të dhënat për përdorimin e drogës, të mbledhura nëpërmjet OSHC-ve në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, midis shtatorit dhe dhjetorit të vitit 2021.
 - 20 Të dhëna të ofruara nga organizata "Healthy Options Project" në Shkup të Maqedonisë së Veriut, në nëntor 2021.
 - 21 Fokus grup me të rinjtë në Mostar të Bosnjës dhe Hercegovinës, 15 tetor 2021.
 - 22 Intervistë me përfaqësues të Qendrës Rinore të Vlorës në Shqipëri, 26 nëntor 2021.
 - 23 Intervistë me Xhanan Berberoviçin (Džanan Berberović), profesor i asociuar në Universitetin e Tuzlës dhe psikolog i autorëve të mitur dhe të rinj në institucionin korrektues-edukativ në Orasje të Bosnjës dhe Hercegovinës, 2 nëntor 2021.
 - 24 Për më shumë informacion, shihni: Ballkani i qëndrueshëm, Gjinia dhe krimi i organizuar, GI-TOC, janar 2022.
 - 25 Intervistë me një përfaqësues të Qendrës Rinore të Vlorës, dhjetor 2021.
 - 26 Kristina Amerhauser dhe Walter Kemp, "Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, GI-TOC, shkurt 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/03/CSO-WBalkans1_ALBANIAN-WEB-2603.pdf.
 - 27 Intervistë me Ela Ljubiçin (Ella Ljubić) në Bosnjë dhe Hercegovinë, 4 nëntor 2021.
 - 28 Intervistë me një përfaqësues të shoqatës për të rinjtë "Kreator" (Youth Association Kreator) në Maqedoninë e Veriut, 27 tetor 2021.
 - 29 Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore, Buletini i rreziqeve, numri 5, GI-TOC, shkurt 2021, <https://globalinitiative.net/analysis/seeobs-risk-bulletin-5/>.
 - 30 Për të mësuar më shumë, shihni: Impact Hub Vienna, në adresën: <https://vienna.impacthub.net/innovation-for-a-better-world/>.
 - 31 Intervistë me një përfaqësues të shoqatës për të rinjtë "Kreator" (Youth Association Kreator) në Maqedoninë e Veriut, 27 tetor 2021.
 - 32 Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore, Buletini i rreziqeve, numri 6, GI-TOC, mars-prill 2021, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/04/SEE-RB06-EN.pdf>.
 - 33 Po aty.
 - 34 Për më shumë informacione, shihni: Fatjona Mejdini dhe Kristina Amerhauser, Ballkani i qëndrueshëm, Gjinia dhe krimi i organizuar, GI-TOC, shkurt 2022, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2022/02/GMFA-Gjinia-dhe-Krimi-i-Organizuar-ALBANIAN-WEB.pdf>.
 - 35 Po aty.
 - 36 Intervistë me një përfaqësues të shoqatës rinore nga rrethi i Bërçkos në Bosnjë dhe Hercegovinë, 4 nëntor 2021.
 - 37 Për të mësuar më shumë lidhur me Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor, shihni: <https://www.rycowb.org>. Të dhënat për Laboratorin Rinor të Ballkanit Perëndimor mund t'i gjeni në adresën: https://www.rcc.int/priority_areas/48/western-balkans-youth-lab-project.



resiliencefund.globalinitiative.net

